# FLETORJA ZYRTARE

# E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

| **Nr. 5** | **2000** | **Mars** |
|---|---|---|

P Ë R M B A J T J A


| | | |
|---|---|---|
| Vendim i K.M nr.8, datë 13.1.2000 | Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.378, datë 12.8.1999, "Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore"..... | 143 |
| Vendim i K.M nr.9, datë 13.1.2000 | Për disa ndryshime në vendimin nr.562, datë 2.12.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin e kërkesave për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar"..... | 145 |
| Vendim i K.M nr.13, datë 13.1.2000 | Për hapjen e shkollës pasuniversitare të administrim biznesit… | 146 |
| Vendim i K.M nr.15, datë 21.1.2000 | Për një shtesë në buxhetin e miratuar për vitin 2000, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, për përballimin e situatës së krijuar nga stuhia detare në rrethin e Lezhës…… | 146 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i K.M nr.16, datë 21.1.2000 | Për bashkimin e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës dhe në Dukatin e Madh të Luksemburgut dhe të misionit të përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Europian…… | 147 |
| Vendim i K.M nr.18, datë 21.1.2000 | Për zotërimin e aksioneve të shoqërisë "Banka Kombëtare Tregtare"…….. | 148 |
| Vendim i K.M nr.21, datë 21.1.2000 | Për disa ndryshime në vendimin nr.834, datë 30.12.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, sh.a"……. | 148 |
| Vendim i K.M nr.22, datë 21.1.2000 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.160, datë 18.3.1996, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në pronësi të Bankës Kombëtare Tregtare, të objekteve dhe truallit të uzinës së prodhimit të makinerive, në Tiranë, dhe të truallit në ish-kënetën e Durrësit"……. | 149 |
| Vendim i K.M nr.24, datë 21.1.2000 | Për një ndryshim në vendimin nr.393, datë 3.9.1992, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore"……. | 149 |
| Vendim i K.M nr.29, datë 28.1.2000 | Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga zgjerimi i segmentit rrugor "Kthesa e Kamzës-Zogu i Zi"…… | 150 |
| Vendim i K.M nr.32 datë 28.1.2000 | Për miratimin e protokollit të sesionit të parë të komisionit të përbashkët ndërqeveritar shqiptaro-kroat, për bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar……. | 153 |
| Vendim i K.M nr.35, datë 28.1.2000 | Për miratimin e protokollit të sesionit të shtatë ndërqeveritar, shqiptaro-grek, për bashkëpunimin ekonomik, industrial, teknik dhe shkencor ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë…… | 153 |
| Vendim i K.M nr.36, datë 28.1.2000 | Për krijimin e komisionit kombëtar shqiptar për Unesco-n….. | 154 |
| Vendim i K.M nr.39, datë 3.2.2000 | Për prokurimin e drejtpërdrejtë për prodhimin dhe konfeksionimin e veshjeve, të artikujve për fjetje, saracerie, dhe të këpucëve gjysma, për nevojat e ushtrisë me ndërmarrjen e prodhimit të veshjeve të ushtrisë….. | 157 |
| Vendim i K.M nr.41, datë 3.2.2000 | Për dhënie shtese pensioni të posaçëm familjeve të Ilirian Arapit dhe Kujtim Frangut……. | 161 |
| Vendim i K.M nr.43, datë 17.2.2000 | Për kalimin në pronësi të një sipërfaqeje trualli, në favor të kishës katolike shqiptare, mbi të cilin do të ndërtohet kompleksi spitalor "Zonja e Këshillit të Mirë"….. | 161 |
| Vendim i K.M | Për shtesë fondesh Ministrisë së Pushtetit Lokal……. | 162 |

| | | |
|---|---|---|
| nr.55, datë 24.2.2000 | | |
| Vendim i K.M nr.56, datë 24.2.2000 | Për import-eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues….. | 162 |
| Vendim i K.M nr.58, datë 24.2.2000 | Për kriteret e vlerësimit të kapitalit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujrave të përdorura në shoqëri tregtare……. | 163 |
| Vendim i K.M nr.73, datë 24.2.2000 | Për shpronësimet për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tri Urat-Çarshovë"…… | 163 |
| Dekret nr.2563, datë 21.2.2000 | Për lënie të shtetësisë shqiptare..... | 169 |
| Vendim i Gj.K nr.64, datë 7.12.1999 | Me objekt: Shpalljen si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.129, datë 18.3.1999 të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat dhe kushtet e dhënies së lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, si dhe pezullimin e zbatimit të tij"..... | 169 |
| Vendim i Gj.K nr.2, datë 25.1.2000 | Me objekt: "Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese"..... | 172 |
| Udhëzim nr.3, datë 11.3.2000 | Për zbatimin e vendimit nr.190, datë 3.5.1995 dhe të V.K.M nr.562, datë 2.12.1999, për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për statusin e veteranit të LANÇ..... | 173 |
| | Kërkesë për shpallje të zhdukur të Tahir Balliut.... | 177 |

**VENDIM**
**Nr. 8, datë 13.1.2000**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 378, DATË 12.8.1999, "PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr. 8482, datë 10. 5. 1999, "Për një shtesë në ligjin nr.7926, datë 10.5.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me akte të tjera ligjore, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e objekteve, për të cilat kalohet e drejta e përfaqësuesit të pronarit për pronën shtetërore, organeve të qeverisjes vendore, shtohen ndërmarrjet sipas listës së bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

Lista e shoqërive/ndërmarrjeve pronë publike, për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit

| Nr. | Shoqëria / Ndërmarrja | Statusi | Rrethi | Qyteti | Vartësia administ. |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Mekanika e Industrisë Ushqimore Sh.A. | Shoqëri Anonime | Elbasan | Elbasan | Lokale |
| 2. | N.G.P. Drithi Sh.A. | Shoqëri Anonime | Korçë | Korçë | MBU |
| 3. | Sheqeri Maliq Sh.A. | Shoqëri Anonime | Korçë | Maliq | MBU |
| 4. | Albimpeks Sh.A. | Shoqëri Anonime | Tiranë | Tiranë | MBU |
| 5. | Fondermek Sh.A. | Shoqëri Anonime | Tiranë | Tiranë | MEPP |
| 6. | IB. ALB.ELECTRONICS Co. | Shoqëri e Përbashkët në likuidim | Durrës | Durrës | MEPP |
| 7. | Dega N.F.I.L. | Ndërmarrje Shtetërore | Berat | Berat | MEPP |
| 8. | Tezgjahu Nr. 1 | Ndërmarrje Shtetërore | Berat | Berat | MEPP |
| 9. | N. Prodhim Buke | Ndërmarrje Shtetërore | Bulqizë | Bulqizë | MBU |
| 10. | N.G.P. Drithi | Ndërmarrje Shtetërore | Dibër | Peshkopi | MBU |
| 11. | N.G.P. Qumështi | Ndërmarrje Shtetërore | Dibër | Peshkopi | MBU |
| 12. | N. Blojes nr. 1 | Ndërmarrje Shtetërore | Dibër | Peshkopi | MBU |
| 13. | N. Blojes nr.2 | Ndërmarrje Shtetërore | Dibër | Peshkopi | MBU |
| 14. | N. Riveshje Goma | Ndërmarrje Shtetërore | Durrës | Durrës | MEPP |
| 15. | Uzina M. Bujqësore | Ndërmarrje Shtetërore | Durrës | Durrës | MEPP |
| 16. | N. Tregti me Shumicë | Ndërmarrje Shtetërore | Durrës | Durrës | MBET |
| 17. | Makinaimpeks | Ndërmarrje Shtetërore | Durrës | Durrës | MBET |
| 18. | N. Frigoriferit | Ndërmarrje Shtetërore | Elbasan | Elbasan | Lokale |
| 19. | Dega N.F.I.L. | Ndërmarrje Shtetërore | Elbasan | Elbasan | MEPP |
| 20. | Uzina Seleksionimit Koksit | Ndërmarrje Shtetërore | Elbasan | Elbasan | MEPP |
| 21. | Uzina Seleksionimit Metaleve | Ndërmarrje Shtetërore | Elbasan | Elbasan | MEPP |
| 22. | N. Prodhimit Bukës | Ndërmarrje Shtetërore | Fier | Patos | Lokale |
| 23. | Dega N.T.P.N. | Ndërmarrje Shtetërore | Fier | | MBET |
| 24. | Uzina Pilave | Ndërmarrje Shtetërore | Gramsh | Gramsh | MM |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 25. | N. Agrotregtare | Ndërmarrje Shtetërore | Has | Has | MBU |
| 26. | N.G.P. Drithi | Ndërmarrje Shtetërore | Has | Has | MBU |
| 27. | Fabrika e Qelqit | Ndërmarrje Shtetërore | Kavajë | Kavajë | MEPP |
| 28. | Depo Frigoriferike (N. Ushqimore) | Ndërmarrje Shtetërore | Kolonjë | Ersekë | MBU |
| 29. | Dega e Shërbimit Gjeologjik | Ndërmarrje Shtetërore | Korçë | Korçë | MEPP |
| 30. | N. Trikotazhit | Ndërmarrje Shtetërore | Korçë | Korçë | MEPP |
| 31. | Uzina Instrumenteve | Ndërmarrje Shtetërore | Korçë | Korçë | MEPP |
| 32 | Uzina Mekanikës Bujqësore | Ndërmarrje Shtetërore | Korçë | Korçë | MEPP |
| 33. | N.T.P.N. | Ndërmarrje Shtetërore | Kukës | Kukës | MBET |
| 34. | N.T.Sh. | Ndërmarrje Shtetërore | Kukës | Kukës | Lokale |
| 35. | N. G. P. | Ndërmarrje Shtetërore | Kurbin | Mamurras | Lokale |
| 36. | A. Sh. L. D. | Ndërmarrje Shtetërore | Kurbin | Laç | MBU |
| 37. | Fabrika e Letrës Lingosulfonat | Ndërmarrje Shtetërore | Kurbin | Laç | Lokale |
| 38. | N. G. P. Drithi | Ndërmarrje Shtetërore | Lezhë | Lezhë | Lokale |
| 39. | Dega e Farnave | Ndërmarrje Shtetërore | Lezhë | Lezhë | MBU |
| 40. | N.R.Sh. Komunale | Ndërmarrje Shtetërore | Lezhë | Lezhë | Lokale |
| 41. | S. M. T. | Ndërmarrje Shtetërore | Librazhd | Librazhd | Lokale |
| 42. | Dega Farnave | Ndërmarrje Shtetërore | Lushnje | Lushnje | MBU |
| 43. | N. G. P. Drithi | Ndërmarrje Shtetërore | Malësi e Madhe | Koplik | MBU |
| 44. | N. G. P. Drithi | Ndërmarrje Shtetërore | Mat | Mat | MBU |
| 45. | Dega e Farnave | Ndërmarrje Shtetërore | Pogradec | Pogradec | MBU |
| 46. | N. Bonifikimit | Ndërmarrje Shtetërore | Pogradec | Pogradec | Lokale |
| 47. | P. A. M. | Ndërmarrje Shtetërore | Pogradec | Pogradec | MT |
| 48. | A. SH. L. D. | Ndërmarrje Shtetërore | Sarandë | Sarandë | MBU |
| 49. | Dega e Farnave | Ndërmarrje Shtetërore | Shkodër | Shkodër | MBU |
| 50. | N. Jometalore | Ndërmarrje Shtetërore | Shkodër | Shkodër | Lokale |
| 51. | N. Lëndës Ngjitëse | Ndërmarrje Shtetërore | Tiranë | Tiranë | MEPP |
| 52. | Fabrika Rërës (Autotraktori) | Ndërmarrje Shtetërore | Tiranë | Tiranë | Lokale |
| 53. | N. Bonifikimi | Ndërmarrje Shtetërore | Tiranë | Tiranë | Lokale |
| 54. | N. Pasurimit Graniteve | Ndërmarrje Shtetërore | Tiranë | Tiranë | Lokale |
| 55. | U. P. N. A. | Ndërmarrje Shtetërore | Tiranë | Tiranë | MEPP |
| 56. | Uzina Remontit Makinave Metalprerëse | Ndërmarrje Shtetërore | Tiranë | Tiranë | MEPP |
| 57. | N. Shërbimeve Mekanike | Ndërmarrje Shtetërore | Tiranë | Tiranë | Lokale |
| 58. | Uzina Kimike e Ushtrisë | Ndërmarrje Shtetërore | Tiranë | Tiranë | MM |

**VENDIM**
**Nr. 9, datë 13. 1.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.562, DATË 2. 12. 1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PRANIMIN E KËRKESAVE PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 8, dhe 14, të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", ndryshuar në ligjin nr. 8526, datë 23. 9. 1999, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.562, datë 2.12.1999 të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin e kërkesave për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit dhe në pikën 1 të këtij vendimi fjalët "kundër pushtuesve nazifashistë" zëvendësohen me fjalët "të Luftës Antifashiste, Nacionalçlirimtare".

2. Në rreshtin e parë të pikës 6, shifra "3"zëvendësohet me shifrën "4"dhe fjalët "dhe shprehja "të komisioneve të rretheve"" hiqen.

3. Në paragrafin e dytë të pikës 6, pas fjalës "Gjithashtu", shtohen fjalët "shprehja "të komisioneve të rretheve"".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 13, datë 13.1.2000**

**PËR HAPJEN E SHKOLLËS PASUNIVERSITARE TË ADMINISTRIM BIZNESIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 37 dhe 38, të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen e shkollës pasuniversitare, 2-vjeçare, pa shkëputje nga puna, të administrim biznesit, pranë Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës, në vitin mësimor 1999-2000.

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i arsimit të lartë dhe nga burime të tjera financiare, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 15, datë 21.1.2000**

**PËR NJË SHTESË NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2000, PËR MINISTRINË E BUJQËSISË DHE USHQIMIT, PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS SË KRIJUAR NGA STUHIA DETARE NË RRETHIN E LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2000, i shtohen 10 (dhjetë) milionë lekë, për përballimin e situatës së krijuar nga stuhia detare në rrethin e Lezhës.

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

2. Punimet të kryhen nga Drejtoria e Ujërave, Lezhë.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 16, datë 21.1.2000**

**PËR BASHKIMIN E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MBRETËRINË E BELGJIKËS DHE NË DUKATIN E MADH TË LUKSEMBURGUT DHE TË MISIONIT TË PËRHERSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetuës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 8370, datë 9.7.1998, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Riorganizimin e ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës dhe në Dukatin e Madh të Luksemburgut dhe të Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Europian.

2. Miratimin e bashkimit të ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës dhe në Dukatin e Madh të Luksemburgut dhe të Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Europian, të quajtur "Përfaqësia diplomatike e Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Europian, në Mbretërinë e Belgjikës dhe në Dukatin e Madh të Luksemburgut".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 18, datë 21.1.2000**

**PËR ZOTËRIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË "BANKA KOMBËTARE TREGTARE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8433, datë 21.12.1998, "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në zbatim të vendimit nr. 218, datë 23.4.1999, të Këshillit të Ministrave, pas negociatave të zhvilluara me investitorët, zotërimi i aksioneve të shoqërisë "Banka Kombëtare Tregtare" të jetë si vijon:

- Kent Bank të zotërojë 60 për qind + 2 aksione;
- Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) të zotërojë 20 për qind- l aksion;
- Koorporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) të zotërojë 20 për qind – 1 aksion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 21, datë 21. 1. 2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.834, DATË 30. 12. 1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE, SH.A."**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.843, datë 21. 12. 1998, "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formës së privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, sh.a.", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.834, datë 30. 12. 1998, të Këshillit të Ministrave, paragrafet 12, 13, 14, 15 dhe 16 të pikës 6 në kapitullin VII, si dhe pikat 1, 2 dhe 3 të kapitullit XI, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr.22, datë 21.1.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.160, DATË 18. 3. 1996, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BANKËS KOMBËTARE**

**TREGTARE, TË OBJEKTEVE DHE TRUALLIT TË UZINËS SË PRODHIMIT TË MAKINERIVE, NË TIRANË, DHE TË TRUALLIT NË ISH-KËNETËN E DURRËSIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1, të ligjit nr.7649, datë 16.12.1992, "Për krijimin e bankës së përbashkët italo-shqiptare", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.160, datë 18.3.1996, të Këshillit të Ministrave, pikat 1,2,3 dhe 4 shfuqizohen.

2. Autorizohet Banka Kombëtare Tregtare, sh.a., që, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të kryejë të gjitha veprimet e duhura për t'ia rikthyer pronarit të mëparshëm Uzinën e Prodhimit të Makinerive, në Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr.24, datë 21. 1. 2000**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 393, DATË 3. 9. 1992, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 bëhen këto ndryshime:

1. Në lidhjen I, "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", në klasifikimin "A.12" shtohet emërtimi "Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit".

2. Në lidhjen II-5, "Nivelet e pagës për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore", në pikën 3, të shtohet emërtimi "Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe në lidhjen II-5/1, "Drejtori të Përgjithshme në varësi të ministrive", në pikën 9, të hiqet emërtimi "Kryetari i Mbrojtjes së Mjedisit".

3. Pagat e punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të jenë sipas lidhjes II-5, "Nivelet e pagës për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore", të vendimit nr.213, datë 28.3.1998, të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 29, datë 28. 1. 2000**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË**

**PREKEN NGA ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR "KTHESA E KAMZËS – ZOGU I ZI"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 9, të ligjit nr. 7848, datë 25.7.1994, "Për shpronësimin për interes publik, si dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive të paluajtshme", me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, truall 17518 m2 objekt ndërtimi 1301m2, që preken nga zgjerimi i segmentit rrugor "Kthesa e Kamzës- Zogu i Zi", në Tiranë, të pronarëve, sipas listave emërore që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të shpërblehen, në lekë, në vlerë të plotë, sipas listave emërore që i bashkëlidhen vendimit, për shumën e përgjithshme prej 85 876 876 (tetëdhjetepesë milionë e tetëqindeshtatëdhjetegjashtë mijë e tetëqindeshtatëdhjetegjashtë) lekësh.

4. Fondi për shpërblimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i miratuar për Ministrinë e Transportit, për këtë objekt, në buxhetin e shtetit për vitin 2000, në zërin "Shpronësime".

5. Shpronësimi të përfundojë brenda vitit 2000.

6. Ngarkohen Ministria e Transportit, Këshilli i Rrethit të Tiranës, Bashkia e Tiranës dhe Komuna e Kasharit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**KËSHILLI I RRETHIT TIRANË**
**BASHKIA TIRANË**
**KOMUNA KASHAR**

Lista e personave, pronat e të cilëve do të shpronësohen si rezultat i zgjerimit të seksionit rrugor Kthesa e Kamzës-Zogu i Zi (Hyrja e Tiranës)

TRUALL

| Nr. | Emër | Atësia | Mbiemër | Sip m2 | Çmimi lekë/m2 | Vlera Totale lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Halil dhe Myslim | | Karapici | 590 | 4660.2 | 274951.8 |
| 2. | Gafurr | | Dibra | 151 | 4660.2 | 703690.2 |
| 3. | Ymer | | Ademi | 66.8 | 4231.2 | 282644.16 |
| 4. | Xhelo | | Dibra | 900 | 4660.2 | 4194180 |
| 5. | Alqi | | Hobdari | 311 | 4660.2 | 1449322.2 |
| 6. | Emrulla | | Gjata | 256 | 4660.2 | 1193011.2 |
| 7. | Banka Islamike | | | 4108 | 4660.2 | 19144101.6 |
| 8. | Nazmi | Qazim | Daja | 467 | 4660.2 | 2176313.4 |
| 9. | Mereme | | Gjinali | 111 | 4660.2 | 517282.2 |
| 10. | Miliam | Hajrulla | Prespa | 208.75 | 4660.2 | 972816.75 |
| 11. | Burhan | Xhavit | Berisha | 1661.5 | 4660.2 | 7742922.3 |
| 12. | Myzejen | Mustafa | Bylyku | 417.5 | 4660.2 | 1945633.5 |
| 13. | Mehmet | Ibrahim | Bylyku | 417.5 | 4660.2 | 1945633.5 |
| 14. | Bedrie | Ali | Bylyku | 375.75 | 4660.2 | 1751070.15 |
| 15. | Naxhie | Isuf | Bylyku | 375.75 | 4660.2 | 1751070.15 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16. | Ibrahim | Abdulla | Xhemnica | 1244 | 4660.2 | 5797288.8 |
| 17. | Isuf | Dalip | Lleshi | 434 | 4660.2 | 2022526.8 |
| 18. | Bukurie | Ali | Bezhani | 488.25 | 4660.2 | 2275342.65 |
| 19. | Sanie | Qazim | Doda | 542.5 | 4660.2 | 2528158.5 |
| 20. | Ahmet | Mustafa | Kaziu | 2500 | 4660.2 | 11650500 |
| 21. | Besim | Avdulla | Berisha | 277 | 4660.2 | 1290875.4 |
| 22. | Ylli | Hajredin | Shima | 468 | 4660.2 | 2180973.6 |
| 23. | Qemal | Ali | Dervishi | 400 | 4660.2 | 1864080 |
| 24. | Shkëlzen | Avdulla | Berisha | 277 | 4660.2 | 1290875.4 |
| 25. | Bilal | Tahir | Gjuzi | 470 | 4660.2 | 2190294 |

Totali 17518.3 8161012446

Mbyllet me numër rendor nr. 25 (njëzet e pesë).

**KËSHILLI I RRETHIT TIRANË**
**BASHKIA TIRANË**
**KOMUNA KASHAR**

Lista e personave, pronat e të cilëve do të shpronësohen si rezultat i zgjerimit të seksionit rrugor Kthesa e Kamzës-Zogu i Zi (Hyrja e Tiranës)

OBJEKTE NDËRTIMI

| Nr. | Emërtimi i Objekteve | | Sip m2 | Çmimi lekë/m2 | Vlera Totale Lek |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Emrulla Gjata | Vendroje | 12 | 889.7 | 10677 |
| 2. | Banka Islamike | Vendroje | 16 | 1406.7 | 22508 |
| 3. | Banka Islamike | Vendroje | 11 | 1339.5 | 14735 |
| 4. | Banka Islamike | Vendroje | 44 | 995.7 | 43811 |
| 5. | Uzina Tirana | Objekt | 28 | 12739.3 | 356701 |
| 6. | Banka Islamike | Vendroje | 40 | 1129.9 | 45198 |
| 7. | Orkestra Frymore | Objekt | 302 | 1046 | 315900 |
| 8. | Banka Islamike | Objekt | 80 | 962.8 | 77025 |
| 9. | Uzina Tirana | Dyqan | 14 | 11455.5 | 160377 |
| 10. | Vendroja “Gintash” | | 5 | 31418 | 157093 |
| 11. | Klubi sportiv Partizani | Objekt | 320 | 453.3 | 145068 |
| 12. | Uzina Tirana | Vendroje | 36 | 1221 | 43956 |
| 13. | Banka Islamike | Objekt | 468 | 540.8 | 253119 |
| 14. | Klubi sportiv Partizani | Objekt | 240 | 682.2 | 163728 |
| 15. | Stacioni mekanik sh.p.k | | 55 | 942.8 | 51856 |
| 16. | Gintash | Objekt | 370ml | 6500 | 2405000 |

Shuma: 1301 4266752

**VENDIM**
**Nr. 32, datë 28.1 2000**

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË SESIONIT TË PARË TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT NDËRQEVERITAR, SHQIPTARO-KROAT, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK DHE TREGTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr.8371, datë 9. 7. 1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtëme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e protokollit të sesionit të parë të komisionit të përbashkët ndërqeveritar, shqiptaro-kroat, për bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 35, datë 28. 1. 2000**

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË SESIONIT TË SHTATË NDËRQEVERITAR, SHQIPTARO- GREK, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, INDUSTRIAL, TEKNIK DHE SHKENCOR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË** GREQISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 8371, datë 9. 7. 1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e protokollit të sesionit të shtatë ndërqeveritar, shqiptaro-grek, për bashkëpunimin ekonomik, industrial, teknik dhe shkencor ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 36, datë 28.1.2000**

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR SHQIPTAR PËR UNESCO-N**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, të ligjit nr.8371, datë 9. 7. 1998, "Për lidhjen e traktateteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të

Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit Kombëtar Shqiptar për UNESCO-n, që më poshtë do të mbahet emërtimi "Komisioni Kombëtar".

Komisioni Kombëtar është një organizëm, që bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme, me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Kryetari i këtij komisioni është ministri i Arsimit dhe Shkencës.

2. Funksionet e Komisionit Kombëtar janë si vijon:

a) Këshillon qeverinë në të gjitha fushat që mbulon UNESCO-ja, sipas programeve të saj.

b) Shërben si koordinator ndërmjet UNESCO-s dhe departamenteve ministrore, instituteve, organizatave dhe individëve, që janë të interesuar për përparimin e arsimit, shkencës, kulturës dhe të informacionit në Republikën e Shqipërisë.

c) Siguron pjesëmarrjen aktive të Republikës së Shqipërisë në përgatitjen, planifikimin, ekzekutimin dhe vlerësimin e programeve e veprimtarive të UNESCO-s.

ç) Bën të njohura objektivat dhe qëllimet e UNESCO-s, nëpërmjet angazhimit të qarqeve intelektuale dhe shkencore, në proçesin e përgatitjes dhe të zbatimit të programeve të UNESCO-s, duke i dhënë përparësi përhapjes ose informacioneve për to.

d) Ndihmon qeverinë në përgatitjet për pjesëmarrjen në sesionet e Konferencës së Përgjithshme dhe të mbledhjeve të tjera ndërqeveritare, të organizuara nga UNESCO-ja.

dh) Nxit dhe zhvillon marrëdhëniet me komisionet e tjera kombëtare për UNESCO-n, në mënyrë të veçantë me ato në rajon, dhe merr pjesë, së bashku me to, në programet e përbashkëta dhe në studimet në interes të Republikës së Shqipërisë.

e) Kryen dhe funksione të tjera, që i ngarkohen nga qeveria.

3. Komisioni Kombëtar përbëhet nga, të shumtën, 30 anëtarë. Anëtarët e Komisionit Kombëtar propozohen e caktohen, me shumicë votash, nga ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për një periudhë deri në 4 vjet, me të drejtë ricaktimi vetëm një herë.

Përbërja e Komisionit Kombëtar është si vijon:

a) Dhjetë anëtarë, përfaqësues të organizmave dhe institucioneve arsimore e shkencore të vendit.

b) Pesë anëtarë, përfaqësues të organizmave dhe institucioneve kulturore të vendit.

c) Tre anëtarë, përfaqësues të medias, gazetarë, e të tjerë.

ç) Katër anëtarë, përfaqësues të organizatave kombëtare joqeveritare, që veprojnë në fushat e veprimtarisë të UNESCO-s.

d) Jo më shumë se katër anëtarë, individë të shquar, personalitete të arsimit, shkencës, kulturës dhe medias.

dh) I deleguari i përhershëm pranë selisë qendrore të UNESCO-s në Paris dhe sekretari i përgjithshëm janë, gjithashtu, anëtarë të Komisionit Kombëtar.

ORGANET E KOMISIONIT KOMBËTAR

A. Asambleja e Përgjithshme

4. Asambleja e Përgjithshme e Komisionit Kombëtar përbëhet nga të gjithë anëtarët e këtij komisioni. Ajo kryesohet nga kryetari i Komisionit Kombëtar. Sekretari i përgjithshëm i këtij komisioni vepron me cilësinë e sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit dhe çdo herë tjetër sipas kërkesës së kryetarit të Komisionit Kombëtar, ose prej shumicës së anëtarëve të saj ose sipas kërkesës së komitetit ekzekutiv, me miratimin e kryetarit të Komisionit Kombëtar.

5. Asambleja e Përgjithshme ka këto funksione:

a) Miraton rapotin e Komisionit Kombëtar dhe të organeve të lidhura me të, si dhe jep rekomandime dhe merr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve dhe veprimtarive të këtij komisioni.

b) Këshillon qeverinë për zgjedhjen e delegacionit për në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s.

c) I jep rekomandime kryetarit të Komisionit Kombëtar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komitetit ekzekutiv dhe të kryetarëve të nënkomiteteve, ose të komiteteve ad-hoc.

ç) Nxit lidhjen e ngushtë dhe bashkëpunimin ndërmjet Komisionit Kombëtar dhe departamenteve ministrore, agjencive, shoqatave profesionale, organizatave joqeveritare, universiteteve dhe qendrave të tjera të kërkimeve shkencore dhe të institucioneve të ndryshme arsimore, shkencore, teknologjike, kulturore dhe të informacionit.

B. Komiteti ekzekutiv.

6. Komiteti ekzekutiv i Komisionit Kombëtar përbëhet nga kryetarët e komiteteve të specializuara dhe kryesohet nga kryetari i Komisionit Kombëtar. Sekretari i Përgjithshëm

i këtij komisioni vepron si sekretar i komitetit ekzekutiv.

Komiteti ekzekutiv mblidhet nga kryetari i tij sa herë është e nevojshme.

7. Komiteti ekzekutiv ka këto funksione:

a) Merr vendime për zbatimin e e programeve të Komisionit Kombëtar në periudhën ndërmjet sesioneve të Asamblesë së Përgjithshme.

b) Këshillon qeverinë për kontributet e saj për planifikimin, ekzekutimin ose vlerësimin e programeve të veprimtarive kombëtare, rajonale, ndërkombëtare të UNESCO-s.

c) Jep këshilla për ndjekjen e veprimeve të rekomanduara nga konferencat e UNESCO-s, nga departamentet e organet qeveritare.

ç) Siguron mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve dhe të rekomandimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe harton raporte për to.

C. Komitetet e specializuara.

8. Komitetet e specializuara përbëhen nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme. Ndarja nëpër komitete e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet nga kryetari i Komisionit Kombëtar.

Kryetarët e komiteteve zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash nga anëtarët e komitetit, në mbledhjen e parë të komiteteve. Anëtarët zgjidhen nga radhët e ekspertëve kombëtarë të fushave të arsimit, shkencës, kulturës dhe informacionit. Komitetet mblidhen sa herë që është e nevojshme.

9. Komitetet e specializuara kanë këto funksione:

a) I japin mendime këshillimore Komisionit Kombëtar dhe organeve të lidhura me të për çështjet brenda përgjegjësive të tyre.

b) Përgatisin raporte, dokumente dhe studime për programet e UNESCO-s, për konferencat e takimet e organizuara nga UNESCO-ja, si dhe për kontributin e organeve shterërore për sa më sipër.

c) Japin rekomandime, sipas kërkesave, për përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e projekteve kombëtare për çështjet brenda përgjegjësive të tyre.

10. Krijohen shtatë komitete që do të mbulojnë këto fusha:

a) Arsimi ( përfshirë arsimin e lartë);

b) Shkencat natyrore dhe teknologjia;

c) Kultura dhe artet;

ç) Shkencat shoqërore dhe humane;

d) Informacioni dhe komunikimi;

dh) Gruaja dhe zhvillimi;

e) Rinia dhe sportet;

Ç. Komitetet ad-hoc.

11. Për realizimin e detyrave të caktuara prej tij, komiteti ekzekutiv mund të krijojë komitetet ad-hoc. Qënia e tyre varet nga periudha e zgjatjes së veprimtarisë për të cilën ata u krijuan.

D. Sekretariati i përhershëm i Komisionit Kombëtar.

12. Komisioni Kombëtar ka një sekretariat të përhershëm, i cili vepron pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, si një sektor në varësi të Drejtorisë që mbulon OKB-në dhe agjencitë e specializuara të saj. Në krye të sekretariatit të përhershëm është sekretari i përgjithshëm i Komisionit Kombëtar, i cili ka funksionin e shefit të këtij sektori.

13. Sekretariati i përhershëm ka këto funksione:

a) Përgatit, në këshillim me komitetitn ekzekutiv, projektprogramin vjetor të Komisionit Kombëtar.

b) Bashkërendon veprimtarinë e Komisionit Kombëtar, si dhe përgatit raportin vjetor për këtë veprimtari;

c) Siguron bashkërendimin dhe këshillimin ndërmjet Komisionit Kombëtar dhe institucioneve dhe agjencive, qeveritare dhe jo qeveritare.

ç) Harmonizon bashkëpunimin ndërmjet komiteteve të specializuara;

d) Nxit studimet dhe projektet në arsim, shkencë, kulturë e informacion, në bashkëpunim me komitetet e specializuara.

dh) Ndjek dhe siguron ekzekutimin sistematik të programeve të UNESCO-s, regjistrimin dhe arkivimin e tyre.

e) Mban lidhje me sekretariatin e UNESCO-s në Paris dhe me komisionet e tjera kombëtare, të rajonit e më gjerë.

ë) Mban lidhje të rregullta me delegacionin e përhershëm të Republikës së Shqipërisë në UNESCO, Paris.

f) Organizon, në bashkëpunim me organizmat e tjera qeveritare ose joqeveritare, mbledhje të UNESCO-s për çështje me interes të përbashkët.

g) Përgatit planin e punës për mbledhjet e Komisionit Kombëtar.

Në mbështetje të funksioneve që parashikon ky vendim dhe të realizimit të korrespondencës me institucionet brenda dhe jashtë vendit, dokumentet e sekretariatit të përhershëm të Komisionit Kombëtar nënshkruhen vetëm nga sekretari i përgjithshëm, me miratimin paraprak të drejtorit të drejtorisë nga e cila ai varet.

Dh. Mjetet dhe burimet financiare.

14. Veprimtaria e Komisionit Kombëtar financohet dhe sponsorizohet nga subjekte e donatorë të ndryshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

15. Ministria e Punëve të Jashtme siguron personelin dhe fondet për mbarëvajtjen e punës për sekretariatin e përhershëm të Komisionit Kombëtar, si dhe mund të financojë pjesëmarrjen e anëtarëve të Komisionit Kombëtar në veprimtari të ndryshme jashtë vendit.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**V E N D I M**
**Nr.39, datë 3.2.2000**

**PËR PROKURIMIN E DREJTPËRDREJTË PËR PRODHIMIN DHE KONFEKSIONIMIN E VESHJEVE, TË ARTIKUJVE PËR FJETJE, SARACERIE, DHE TË KEPUCËVE GJYSMA, PËR NEVOJAT E USHTRISË ME NDËRMARRJEN E PRODHIMIT TË VESHJEVE TË USHTRISË.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, "Për Prokurimin Publik", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Ministria e Mbrojtjes, për garantimin e cilësisë, të dizenjove, standardeve të paraqitjes estetike, të furnizimit ritmik të ushtrisë dhe për përballimin e urgjencave për veshje, saraceri, këpucë gjysma, te prokurojë, per vitin 2000, drejpërdrejtë me ndërmarrjen e prodhimit të veshjeve të ushtrisë, ne Tiranë për artikujt e mëposhtëm :

a) Për prodhimin dhe konfeksionimin e veshjeve: kostume teritali, ushtarake e civile, kostume kamuflazhi, për kuadro dhe ushtarë, xhupa, veshje te brendshme, verore e dimërore, për ushtarë, çarçafë, dyshekë.

b) Për prodhime saraci: mbulesa për sistemet e artilerisë, te aviacionit, tankeve, automjeteve,

për ndërlidhjen, për kiminë, për armatimin e lehtë, municionet, jelekë për mbajtjen e pajimeve të ndryshme për ushtarët, pajime për kafshët, çadra për fushimin e ushtrisë.

c) Për prodhim këpucësh: vetëm për këpucë gjysma për kuadrot.

Specifikimi me i hollësishëm i konfeksionimeve, që do të realizohen me prokurim të drejpërdrejtë, jepet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Çmimet e prodhimit dhe të konfeksionimit për çdo artikull të hartohen nga ndërmarrja e prodhimit të veshjeve të ushtrisë, me analiza analitike të kostos, kurse negociimi dhe miratimi i tyre të bëhet nga Ministria e Mbrojtjes.

3. Enti prokurues, i autorizuar nga Ministria e Mbrojtjes, me miratimin e çmimeve, të lidhë kontratë me ndërmarrjen e prodhimit të veshjeve të ushtrisë, ku të shënohen të gjitha specifikimet e nevojshme teknike të prodhimit të dorëzimit të mallit. Në kontratë, për rastet e konfeksionimit, të specifikohet edhe ritmika e furnizimit me lëndë të para nga enti prokurues.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

| Nr. | Emërtimi i artikullit | Çmimi | Karakteristikat Teknike | Lloji i prodhimit |
|---|---|---|---|---|
| 1. | 2. | 3. | 4. | 5. |
| A. | PRODHIME SARACERIE | | | |
| 1. | Mbulese komplet mitrolozi 14.5mm 4-grykësh | 9099 | Suprime teknike Kunder depertimit ujit e veprimeve te agjenteve atmosferike | Me Material Porositesi |
| 2. | Mbulese komplet topi 37mm KA një-grykësh | 9642 | „ „ | „ „ |
| 3. | Mbulese komplet topi 37mm KA dy-grykesh | 11376 | „ „ | „ „ |
| 4. | Mbulese komplet topi 57mm KA | 20592 | „ „ | „ „ |
| 5. | Mbulese komplet topi 85mm fushor | 16505 | „ „ | „ „ |
| 6. | Mbulese komplet topi 100mm KA | 16159 | „ „ | „ „ |
| 7. | Mbulese komplet topi 122mm,fush | 13324 | „ „ | „ „ |
| 8. | Mbulese komplet topi obus122mm | 16943 | „ „ | „ „ |
| 9 | Mbulese komplet topi obus 152mm Fushor. | 16576 | „ „ | „ „ |
| 10. | Mbulese komplet per avion | 16350 | „ „ | „ „ |
| 11. | Mbulese komplet per helikopter | 13750 | „ „ | „ „ |
| 12. | Çadra te medha ushtari | 30880 | „ „ | „ „ |
| 13. | Çadra te mesme ushtari | 18000 | „ „ | „ „ |
| 14. | Çadra te vogla shtabi | 14000 | „ „ | „ „ |
| 15. | Çadra kuzhine | 30000 | „ „ | „ „ |
| 16. | Çadra spitali | 30000 | „ „ | „ „ |
| 17. | Flete çadre | 12000 | „ „ | „ „ |
| 18. | Çanta shpine | 10400 | „ „ | „ „ |
| B. | VESHJE KUADRI ( oficer-n/oficer) | | | |
| 1. | Pardesy | 3198 | Stof terital | „ „ |
| 2. | Xhup kamuflazhi | 4000 | Kamuflazh | „ „ |
| 3. | Kostum ceremonial kuadri | 5283 | Stof terital | „ „ |
| a. | Xhaketë | 3241 | „ „ | „ „ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| b. | Pantallona | 804 | „ „ | „ „ |
| c. | Kapele | 455 | „ „ | „ „ |
| 4. | Kostum pune kuadri | 1666 | „ „ | „ „ |
| a. | Xhaketë | 892 | „ „ | „ „ |
| b. | Pantallona | 562 | „ „ | „ „ |
| c. | Kapele | 212 | „ „ | „ „ |
| 5. | Këmishë kuadri me mëngë të shkurtra | 301 | „ „ | „ „ |

| 1. | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|
| 6. | Këmishe kuadri me mëngë të gjata | 365 | „ „ | „ „ |
| 7. | Kravate | 73 | „ „ | „ „ |
| 8. | Pantallona vere kuadri | 562 | „ „ | „ „ |
| 9. | Kapele vere kuadri | 892 | „ „ | „ „ |
| 10. | Kostum stërvitje dimërore Kamuflazhi ( kuadri) | 1666 | Kamuflazhi | „ „ |
| a. | Xhakete | 892 | „ „ | „ „ |
| b. | Pantallona | 562 | „ „ | „ „ |
| c. | Kapele | 212 | „ „ | „ „ |
| 11. | Kostum stërvitje verore kamuflazhi ( verore) | 1666 | „ „ | „ „ |
| a. | Xhakete | 892 | „ „ | „ „ |
| b. | Pantallona | 562 | „ „ | „ „ |
| c. | Kapele | 212 | „ „ | „ „ |
| 12. | Kepuce ½ kuadri | 2500 | Lekure poliureta | „ „ |
| C. | VESHJE USHTARI | | | |
| 1. | Xhupa kamuflazhi | 40000 | Kamuflazh | „ „ |
| 2. | Kostum dimeror kamuflazhi ushtari | 1400 | „ „ | „ „ |
| a. | Xhaketë | 800 | „ „ | „ „ |
| b. | Pantallona | 420 | „ „ | „ „ |
| c. | Kapele | 200 | „ „ | „ „ |
| 3. | Kostum veror kamuflazhi ushtari | 1400 | „ „ | „ „ |
| a. | Xhakete | 800 | „ „ | „ „ |
| b. | Pantallona | 420 | „ „ | „ „ |
| c. | Kapele | 200 | „ „ | „ „ |
| 4. | Të brendshme dimri | 930 | Fanellate | „ „ |
| a. | Këmisha | 630 | „ „ | „ „ |
| b. | Benevreke | 300 | „ „ | „ „ |
| 5. | Te brendshme vere | 460 | Pelhure | „ „ |
| a. | Këmisha | 320 | | „ „ |
| b. | Mbathje | 140 | | „ „ |
| 6. | Pece kembesh dimri | 150 | Fanellate | „ „ |
| 7. | Pece kembesh vere | 120 | Pelhure | „ „ |
| 8. | Shami dore | 100 | Kambrik | „ „ |
| 9. | Kostum stervitje per floten | 1666 | Dok | „ „ |
| a. | Xhakete doku per floten | 892 | Dok | „ „ |
| b. | Pantallon doku per floten | 562 | Dok | „ „ |
| c. | Kapele doku per floten | 212 | Dok | „ „ |
| D. | MATERIALE PER FJETJE | | | |
| 1. | Çarçafe | 498 | Kambrik | „ „ |
| 2. | Kellef dysheku | 800 | Dok | „ „ |
| 3. | Dyshek te mbushur | 2323 | Dok+pamb(lesh) | „ „ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4. | Kellef jasteku | 180 | Kambrik | „ „ |

**V E N D I M**
**Nr. 41,datë 3.2.2000**

**PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM FAMILJEVE TË ILIRIAN ARAPIT DHE KUJTIM FRANGUT**

Në mbështetje të paragrafit 2, pika "b", të nenit 5, të ligjit nr.7703, datë 11.9.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

T'u jepet shtesë pensioni të posaçëm :
Znj. Vera Sulejman Arapi 5 mijë lekë në muaj.
Znj. Fitnet Ali Frangu 6 mijë lekë në muaj.
Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2000.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**V E N D I M**
**Nr. 43, datë 17.2.2000**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË NJË SIPËRFAQJEJE TRUALLI, NË FAVOR TË KISHËS KATOLIKE SHQIPTARE, MBI TË CILIN DO TË NDËRTOHET KOMPLEKSI SPITALOR “ZONJA E KËSHILLIT TË MIRË“**

Në mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës, të neneve 3 dhe 4, te ligjit nr 7980, datë 27.7.1995, "Për shitblerjen e trojeve", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin në pronësi të Kishës Katolike Shqiptare, të një sipërfaqeje trualli prej
5 hektarësh, sipas gentplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, mbi të cilin ngrihet kompleksi spitalor "Zonja e Këshillit të Mirë".
Koeficienti i përllogaritjes së çmimit të shitjes së truallit të jetë 0,001.
1. Ngarkohet bashkia e Tiranës për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes.
Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**V E N D I M**
**Nr. 55, datë 24.2.2000**

**PËR SHTESË FONDESH MINISTRISË SË PUSHTETIT LOKAL**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Pushtetit Lokal në buxhetin e vitit 2000, i shtohen 10 milionë lekë, për blerjen e dy objekteve brenda territorit të objektit ish-hotel "Drini".
2. Fondi për blerjen e objekteve të mësipërme të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**V E N D I M**
**Nr. 56, datë 24.2.2000**

**PËR IMPORT-EKSPORTIN E BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 82, pika 3, të Kodit Doganor, të neneve 3 dhe 7, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Veprimet në pikat doganore për import-eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues të kryhen vetëm pasi personat, juridikë apo fizikë, të kenë paraqitur dokumentacionin shtesë, si vijon:
- Liçensën për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, të lëshuar nga komisioni i mbrojtjes nga rrezatimet, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.
- Lejen për import-eksportin e burimeve jonizuese, lëshuar nga zyra e mbrojtjes nga rrezatimet.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimit përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të Fletores Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**V E N D I M**
**Nr.58, datë 24.2.2000**

**PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRIVE QË KRIJOHEN NGA TRANSFORMIMI I NDËRMARRJEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA NË SHOQËRI TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për

transformimin e ndërmarrjeve shtetëtore në shoqëri tregtare" ndryshuar me ligjin nr. 8067, datë 15.2.1996 dhe me ligjin nr. 8099, datë 28.3.1996, me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Vlerësimi i kapitalit të shoqërive që krijohen nga transformimi në shoqëri tregtare i ndërmarrjeve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura do të bëhet sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 20.3.1998 "Për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**V E N D I M**
**Nr. 73, datë 24.2.2000**

**PËR SHPRONËSIMET PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "TRI URAT-ÇARSHOVË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 9, të ligjit nr. 7848, datë 25.7.1994, "Për shpronësimin për interes publik, si dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive të paluajtshme", me propozimin e Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tri Urat-Çarshovë", të ndodhura në territorin e rrethit të Përmetit, sipas listave emërore përkatëse, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi:truall 121.5 m2 , tokë bujqësore 14661.3 m2 , objekt ndërtimi 158.5 m2 .

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas listave emërore, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për shumën prej

14 443 907 (katërmbëdhjetë milionë e katërqintedyzetre mijë e nëntëqindeshtatë) lekë.

3. Fondi për shpronësimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i miratuar për këtë objekt për Ministrinë e Transportit, në buxhetin e shtetit të vitit 2000, në zërin "Shpronësime".

4. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të përfundojë brenda vitit 2000.

5. Ngarkohen nga Ministria e Transportit, Ministria e Pushtetit Lokal, këshilli i rrethit Përmet dhe komuna Çarshovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

**RRETHI PËRMET KOMUNA**

LISTA EMËRORE E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË

SEGMETIT RRUGOR ÇARSHOVË-TRE URAT

Lloji i pasurisë së paluajtshme, tokë bujqësore dhe truall Nr. (1-140)

| Nr | Emër | Atësi | Mbiemër | Sipërfaqe m2 | Çmimi lek/m2 | Vlera lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Jani | Pavllo | Ceqi | 404.2 | 700 | 282940 |
| 2. | Kujtim | Kadri | Sulo | 57 | 700 | 39900 |
| 3. | Stefan | Lilo | Liço | 217.7 | 700 | 152390 |
| 4. | Polikron | Llukan | Koto | 22.2 | 700 | 15540 |
| 5. | Uran | Qemal | Suli | 113 | 700 | 79100 |
| 6. | Gëzim | Seit | Lapi | 61.7 | 700 | 43190 |
| 7. | Taqo | Koço | Llave | 140.1 | 700 | 98070 |
| 8. | Apostol | Vangjel | Saqellari | 165.2 | 700 | 115640 |
| 9. | Kiço | Sotir | Xhallo | 84.4 | 700 | 59080 |
| 10. | Polikron | Kiço | Stefani | 33.6 | 700 | 23520 |
| 11. | Sulo | Bajram | Lapi | 70 | 700 | 49000 |
| 12. | Theodhor | Lilo | Kuleci | 358.2 | 700 | 250740 |
| 13. | Gjergji | Koço | Haxhi | 44 | 700 | 30800 |
| 14. | Zelul | Bame | Saliaj | 25.2 | 700 | 17640 |
| 15. | Fore | Stavro | Vangjeli | 109.4 | 700 | 76580 |
| 16. | Iljaz | Duro | Comani | 43.6 | 700 | 30520 |
| 17. | Koçi | Kiço | Stefani | 35.2 | 700 | 24640 |
| 18. | Viktor | Theodhor | Jahu | 81.7 | 700 | 57190 |
| 19. | Vasil | Ligor | Bidika | 58 | 700 | 40600 |
| 20 | Josif | Koço | Ilia | 47.7 | 700 | 33390 |
| 21. | Janaq | Josif | Lile | 69.2 | 700 | 48440 |
| 22. | Stavro | Petro | Vangjeli | 152 | 700 | 106400 |
| 23. | Stefan | Stavro | Xhallo | 19 | 700 | 13300 |
| 24. | Mitre | Mina | Proko | 19.2 | 700 | 13440 |
| 25. | Frosina | Thanas | Thimjo | 72.2 | 700 | 50540 |
| 26. | Foti | Ilia | Jani | 215.7 | 700 | 150990 |
| 27. | Stavro | Josif | Janku | 57.5 | 700 | 40250 |
| 28. | Rami | Kadri | Sulo | 125 | 700 | 87500 |
| 29. | Lili | Vangjel | Minolla | 148.5 | 700 | 103950 |
| 30. | Thoma | Janaq | Misho | 88.8 | 700 | 62160 |
| 31. | Jorgji | Lilo | Ngjela | 135.3 | 700 | 94710 |
| 32. | Vasil | Jorgji | Kristo | 45.6 | 700 | 31920 |
| 33. | Gani | Kaman | Laska | 116 | 700 | 81200 |
| 34. | Musa | Kaman | Laska | 55.3 | 700 | 38710 |
| 35. | Vangjel | Janaq | Lile | 28.7 | 700 | 20090 |
| 36. | Sotir | Aleks | Petro | 17.7 | 700 | 12390 |
| 37. | Lilo | Vangjel | Diamanti | 61 | 700 | 42700 |
| 38. | Hysen | Bame | Saliaj | 19.6 | 700 | 13720 |
| 39. | Zani | Abedin | Laska | 30.4 | 700 | 21280 |
| 40. | Jorgji | Pano | Stefani | 27 | 700 | 18900 |
| 41. | Ligor | Pandeli | Haxhi | 138.5 | 700 | 96950 |
| 42. | Sotir | Ilia | Jani | 10 | 700 | 7000 |
| 43. | Spiro | Llazo | Derasa | 33.3 | 700 | 23310 |
| 44. | Foti | Llazo | Bili | 118.2 | 700 | 82740 |
| 45, | Koço | Ligor | Haxhi | 51 | 700 | 35700 |
| 46. | Nesti | Viktor | Ilia | 32.2 | 700 | 22540 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 47. | Koço | Panajot | Kruti | 31 | 700 | 21700 |
| 48. | Jorgo | Kristo | Qirici | 59.7 | 700 | 41790 |
| 49. | Trifon | Petro | Cicolli | 416.4 | 700 | 291480 |
| 50. | Jorgo | Filip | Karajani | 1670 | 700 | 1169000 |
| 51. | Vasil | Koço | Mandi | 249 | 700 | 174300 |
| 52. | Vangjel | Llazo | Druri | 257.9 | 700 | 180530 |
| 53. | Miço | | Nika | 104.1 | 700 | 72870 |
| 54. | Agim | Neim | Ruci | 120 | 700 | 84000 |
| 55. | Foti | Mihal | Nikolla | 94.7 | 700 | 66290 |
| 56. | Ahmet | Kadri | Sulo | 86.6 | 700 | 60620 |
| 57. | Bektash | Ismail | Beqiri | 237.2 | 700 | 166040 |
| 58. | Astrit | Xhemal | Ago | 316.5 | 700 | 221550 |
| 59. | Kleanth | Vangjel | Dhimitri | 19.3 | 700 | 13510 |
| 60. | Spiro | Sokrat | Xhillari | 20.8 | 700 | 14560 |
| 61. | Stavro | Sotir | Xhallo | 20 | 700 | 14000 |
| 62. | Foti | Trifon | Naco | 14.4 | 700 | 10080 |
| 63. | Kiço | Vasil | Proko | 100 | 700 | 70000 |
| 64. | Mondi | Iljaz | Gomani | 73.2 | 700 | 51240 |
| 65. | Llambi | Stefan | Apostoli | 59.5 | 700 | 41650 |
| 66. | Anastas | Jorgji | Kristo | 57.2 | 700 | 40040 |
| 67. | Stavro | Ligor | Koto | 63.1 | 700 | 44170 |
| 68. | Miço | Foti | Petro | 140 | 700 | 98000 |
| 69. | Vasil | Petro | Stefo | 44.8 | 700 | 31360 |
| 70. | Kiço | Jorgji | Bozili | 42.2 | 700 | 29540 |
| 71. | Ismail | Shefki | Male | 17.8 | 700 | 12460 |
| 72. | Kristaq | Koço | Papa | 22.8 | 700 | 15960 |
| 73. | Novruz | Gani | Zaimi | 14 | 700 | 9800 |
| 74. | Polikron | Koço | Kruti | 31.6 | 700 | 22120 |
| 75. | Petro | Vasil | Dode | 36.6 | 700 | 25620 |
| 76. | Sadik | Ibrahim | Saliaj | 52.7 | 700 | 36890 |
| 77. | Kiço | Josif | Boci | 27 | 700 | 18900 |
| 78. | Kiço | Lilo | Temo | 59.4 | 700 | 41580 |
| 79. | Lilo | Josif | Temo | 37.2 | 700 | 26040 |
| 80. | Bilbil | Haxhi | Lapi | 20.7 | 700 | 14490 |
| 81. | Llukan | Vasil | Jaho | 121.5 | 700 | 85050 |
| 82. | Janaq | Vasil | Jaho | 10.5 | 700 | 7350 |
| 83. | Vasil | Mihal | Kita | 820 | 700 | 574000 |
| 84. | Sofo | Vasil | Zahari | 42 | 700 | 29400 |
| 85. | Sotir | Aleks | Petro | 51 | 700 | 35700 |
| 86. | Vasil | Stefan | Petro | 49.4 | 700 | 34580 |
| 87. | Arben | Thanas | Mandi | 292.6 | 700 | 204820 |
| 88. | Stefan | Sotir | Petro | 19 | 700 | 13300 |
| 89. | Thanas | Niko | Curo | 24.6 | 700 | 17220 |
| 90. | Llambi | Mitre | Proko | 21.5 | 700 | 15050 |
| 91. | Seit | Barjam | Lapi | 26 | 700 | 18200 |
| 92. | Ramiz | Seit | Lapi | 28 | 700 | 19600 |
| 93. | Vali | Ilia | Sharko | 20 | 700 | 14000 |
| 94. | Vangjel | Vasil | Janku | 16.4 | 700 | 11480 |
| 95. | Vaso | Vasil | Kobuzi | 18.7 | 700 | 13090 |
| 96. | Stavro | Llukan | Liço | 19.2 | 700 | 13440 |
| 97. | Dylbel | Haxhi | Lapi | 17.2 | 700 | 12040 |
| 98. | Haxhi | Barjam | Lapi | 36.1 | 700 | 25270 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 99. | Stire | Koço | Ilia | 23.1 | 700 | 16170 |
| 100. | Lilo | Misto | Proko | 22.4 | 700 | 15680 |
| 101. | Josif | Kiço | Boci | 20.3 | 700 | 14210 |
| 102. | Vasil | Kiço | Boci | 23.6 | 700 | 16520 |
| 103. | Mondi | Ilia | Jani | 33.3 | 700 | 23310 |
| 104. | Dhiogjen | Ilia | Jani | 30 | 700 | 21000 |
| 105. | Thoma | Stavro | Janku | 25 | 700 | 17500 |
| 106. | Jani | Vasil | Xhallo | 45 | 700 | 31500 |
| 107. | Pandi | Kiço | Xhallo | 45.2 | 700 | 31640 |
| 108. | Llazo | Vasil | Derasa | 21.5 | 700 | 15050 |
| 109. | Koço | Jorgji | Ngjiro | 33.6 | 700 | 23520 |
| 110. | Gaqe | Andrea | Ngjiro | 29 | 700 | 20300 |
| 111. | Kolo | Vasil | Zahari | 15.5 | 700 | 10850 |
| 112. | Sotir | Petro | Dode | 52 | 700 | 36400 |
| 113. | Sotir | Mihal | Bidika | 95 | 700 | 66500 |
| 114. | Jorgaq | Llukan | Liço | 44.2 | 700 | 30940 |
| 115. | Lilo | Llukan | Lico | 21.6 | 700 | 15120 |
| 116. | Nazif | Barjam | Lapi | 22.2 | 700 | 15540 |
| 117. | Petrit | Dhionis | Jani | 92 | 700 | 64400 |
| 118. | Vasil | Pavllo | Ceqi | 29 | 700 | 20300 |
| 119. | Polikron | Thanas | Laço | 55.8 | 700 | 39060 |
| 120. | Skënder | Laske | Laska | 117.3 | 700 | 82110 |
| 121. | Nertil | Stefan | Petro | 35.2 | 700 | 24640 |
| 122. | Androkli | Janaq | Misho | 51.6 | 700 | 36120 |
| 123. | Fshati | Psillotere | | 344 | 700 | 240800 |
| 124. | Fatos | Abaz | Zaimi | 26 | 700 | 18200 |
| 125. | Poli | Thanas | Dode | 24 | 700 | 16800 |
| 126. | Sotir | Kiço | Kruti | 23 | 700 | 16100 |
| 127. | Gaqe | Ligor | Sharko | 219 | 700 | 153300 |
| 128. | Mitre | Mihal | Proko | 42 | 700 | 29400 |
| 129. | Jorgo | Andrea | Ngjiro | 77 | 700 | 53900 |
| 130. | Koço | Jorgo | Ngjiro | 107 | 700 | 74900 |
| 131. | Mihallaq | Foti | Kita | 108 | 700 | 75600 |
| 132. | Sotir | Dhimitër | Sharko | 166.4 | 700 | 116480 |
| 133. | Mihallaq | Thanas | Bidika | 145.4 | 700 | 101780 |
| 134. | Niko | Sotir | Naçi | 24 | 700 | 16800 |
| 135. | Kujtim | Abedin | Laska | 50 | 700 | 35000 |
| 136. | Foti | Aleks | Apostoli | 275 | 700 | 192500 |
| 137. | Hajdar | Ahmeti | Ahmeti | 579 | 700 | 405300 |
| 138. | Dhimitër | Thanas | Derrasa | 579 | 700 | 405300 |
| 139. | Viron | Lipe | Bidika | 579 | 700 | 405300 |
| 140. | Truall | | | 121.5 | 1100 | 133650 |
| | Totali | | | 14782.8 | | 10396560 |

Mbyllet me numër rendor 140 (njëqintedyzet)

KRYETARI I KOMUNËSKRYETARI I KËSHILLIT TË RRETHIT
Foti ApostoliEdmond Theodhori

DREJTORI I BUJQËSISË SË RRETHITAGRONOMI
Xhevdet Hadaj  Fatos Zaimi

URBANISTIKAFINANCA KADASTRA
Niko MihaliBilbil MullaiVangjel Qirjako

Lloji i pasurisë së paluajtshme, objekt ndërtimi Nr.1

| Nr | Emër | Atësi | Mbiemër | Sipërfaqe m2 | Çmimi lek/m2 | Vlera lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Abaz | | Lara | 158.5 | 25 535 | 4047347 |
| | Totali | | | 158.5 | | 4047347 |

Mbyllet me numër rendor 1 (një)

**D E K R E T**
**Nr. 2563, datë 21.2.2000**

**PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Luiza Astrit Mullai
2. Përparim Vesel Hoti
3. Valbona Agim Reinders (Ibërshimi)
4. Villam Ylli Rusi
5. Brian Hamdi Villam Rusi
6. Jesie Fiqiri Rusi
7. Sashenka Muhamet Rusi
8. Andrea Vasil Kushti
9. Arvit Ismet Beci
10. Enrik Aleksandër Bregasi
11. Izabel Enrik Bregasi
12. Marko Enrik Bregasi
13. Ilirjana Ibrahim Bregasi (Stafa)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
**Rexhep Meidani**

**V E N D I M**

**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:
Fehmi Abdiu,Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Hilmi Dakli,Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin FugaAnëtar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço,Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Kristofor Peçi,Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Kujtim Puto,Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Sokol Sadushi,Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Me sekretare Drita Filto, më datë 26.10.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr. 57, Akti që i përket:

KËRKUESE: DHOMA E TREGTISË DHE INDUSTRISË VLORË, e përfaqësuar nga kryetari Bardhyl Nasto dhe Avokat Ilirjan Deshalla, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

OBJEKTI: Shpallja si i papajtueshëm me Kushtetutën i Vendimit nr. 129, datë 18.03.1999 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat dhe kushtet e dhënies së lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", si dhe pezullimin e zbatimit të tij.

Kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi, duke parashtruar këto shkaqe:

1. Në kundërshtim me nenet 100/4 e 117/1-rë të Kushtetutës ky vendim që thuhet se është nxjerrë me propozim të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në Fletoren Zyrtare është botuar pa firmën e tij.

2. Gjithashtu vendimi në fjalë në kundërshtim me nenin 118/2 të Kushtetutës, nuk bazohet në parimet e Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 dhe ka dalë jashtë këtyre parimeve.

3. Duke vendosur kushte për kapitalin financiar dhe kapacitetin e depozitave për rezervën e naftës e të gazit, të cilat janë të papërballueshme nga subjektet tregtare, ky akt, në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës, ka bërë kufizime të lirisë së tyre në ushtrimin e kësaj veprimtarie ekonomike, kufizime këto që mund të vendosen vetëm me ligj.

4. Zbatimi i këtij vendimi do të sjellë monopolizimin e kësaj veprimtarie në dorën e dy ose tre subjekteve të fuqishëm dhe falimentimin e subjekteve të tjera, duke cënuar kështu parimet e ekonomisë së tregut të lirë dhe të ligjit për konkurencën.

## GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të palës kërkuese dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Shkaqet që ka parashtruar Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Vlorë për papajtueshmëri me Kushtetutën të Vendimit nr. 129, datë 18.03.1999 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre", janë të pabazuara. Për rrjedhojë kërkesa e saj për shfuqizimin e këtij vendimi si antikushtetues, nuk duhet pranuar.

Fakti, se ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare pa kundërfirmën e Ministrit propozues, nuk do të thotë se një veprim i tillë vjen në kundërshtim me pikën 4 të nenit 100 të Kushtetutës. Respektimi i kësaj kërkese të parashikuar në këtë dispozitë kërkohet vetëm për efekt të vlefshmërisë së akteve që nxjerr Këshilli i Ministrave dhe ka të bëjë jo vetëm me fazën e publikimit, po me atë të miratimit të tyre.

Në këtë fazë, siç rezultoi gjatë gjykimit, ky organ, për rastin konkret, e ka zbatuar këtë rregull kushtetues. Vendimin e sipërpërmendur e ka nënshkruar, përveç Kryeministrit, edhe ministri propozues, Ylli Bufi. Kjo gjë vërtetohet me nënshkrimin e tij në kopjen e këtij akti, e cila i është dërguar të gjitha institucioneve, disa muaj përpara se kërkuesi t'i drejtohej kësaj Gjykate.

Nga ana tjetër, përmbajtja e këtij vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare. Ky fakt është i mjaftueshëm për t'i dhënë këtij akti nënligjor fuqinë e tij juridike, ashtu siç parashikohet në nenin 117 të Kushtetutës.

Të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera të kërkuesit.

Nga shqyrtimi në tërësi i Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe

tregtimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre", del se me dispozita të tij të veçanta që i përkasin neneve 9, 18, 19/3, 20/4, 21 dhe 23, Këshilli i Ministrave është ngarkuar në mënyrë të shprehur që të rregullojë me akte nënligjore këtë fushë të veprimtarisë ekonomike. Pikërisht mbi këtë bazë dhe jo në mënyrë arbitrare, siç pretendon kërkuesi, ai ka nxjerrë vendimin e tij, objekt i kontrollit të kësaj Gjykate.

Nga ana tjetër, kushtet e parashikuara në këtë vendim për tregtimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, vërtet e ngushtojnë në një farë mase sferën e ushtrimit të kësaj veprimtarie, por ato nuk janë veçse kritere, sepse janë të prejardhura ose të diktuara nga kufizimet që i ka vënë asaj vetë ligji.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 11 të Kushtetuës ka vendosur këto kufizime vetëm për arsye të rëndësishme publike, ndërsa Këshilli i Ministrave, brenda kuadrit të këtyre kufizimeve ka përcaktuar kriteret për zhvillimin e kësaj veprimtarie, me burim rreziku të shtuar që paraqet rëndësi të veçantë për ekonominë kombëtare, mjedisin dhe mbrojtjen e vendit.

Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se Vendimi i Këshillit të Ministrave nuk përmban kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe për rrjedhojë nuk ka përmbajtje antikushtetuese sikurse pretendon pala kërkuese.

Po ashtu, ajo nuk e gjen të bazuar edhe pretendimin lidhur me pasojat që mund të sjellë zbatimi i këtij vendimi, i cili sipas tij do të çojë në monopolizimin e kësaj veprimtarie në dorën e dy ose tre subjekteve më të fuqishëm, duke mënjanuar kështu konkurrencën e lirë dhe duke shkaktuar ngritjen e çmimeve.

Ardhja e këtyre pasojave nuk është evidente. Ato edhe në qoftë se vërtetohen, Këshilli i Ministrave mund t'i eleminojë, duke ndryshuar në çdo kohë, sipas diskrecionit të tij dhe brenda kufijve të ligjit, kriteret që ai ka parashikuar në këtë vendim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a,c dhe 134/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 41 të Ligjit nr. 8373, datë 15.07.1998, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës, si të pabazuar.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 07.12.1999
Nr. 57 i regjistrit themeltar
Nr. 64 i Vendimit

**V E N D I M**
**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:
Fehmi Abdiu,Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga,Anëtar i ""
Alfred Karamuço,Anëtar i""
Bardha Selenica,Anëtare e""
Kristofor Peçi,Anëtar i""
Kujtim Puto,Anëtar i""
Sokol Sadushi,Anëtar i ""

Me sekretare Drita Filto, më datë 25.01.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr. 8, Akti që i përket:

KËRKUES:HILMI DAKLI
OBJEKTI:Deklarimi i mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.
BAZA LIGJORE: Neni 128 pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

Pasi administroi kërkesën për dorëheqje të zotit Hilmi Dakli, anëtar i Gjykatës Kushtetuese,

V Ë R E N

Zoti Hilmi Dakli, anëtar i Gjykatës Kushtetutese në datën 24.01.2000, ka deklaruar se jep dorëheqjen nga detyra që kryen.

Gjykata Kushtetuese, konstatoi faktin e dorëheqjes së tij dhe e gjeti atë të bazuar në nenin 127 pika "ç" e Kushtetutës.

Duke qenë kështu, ajo çmon se konform pikës 2 të këtij neni, duhet deklaruar mbarimi i këtij mandati.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 41 të Ligjit nr. 8373, datë 15.07.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

Të deklarojë mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Hilmi Dakli.
Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Tiranë më 25.01.2000
Nr. 8 i regjistrit themeltar
Nr. 2 i Vendimit

**UDHËZIM**
**Nr. 3, datë 11.1.2000**

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT NR.190, DATË 03.05.1995 DHE TË V.K.M. NR. 562, DATË 02.12.1999, PËR PRANIMIN DHE SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE.**

Bazuar në Ligjin Nr.7874, datë 17.11.1994 ,"Për Statusin e Veteranit të Luftës", në Ligjin Nr. 8526, datë 23.09.1999, për zbatimin e Vendimit Nr.190, datë 03.05.1995 dhe të V.K.M. Nr. 562, datë 02.12.1999 "Për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për Statusin e Veteranit të Luftës ANÇL" me propozim të Departamentit të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës ,

U D H Ë Z O J:

I.Komisioni i statutit të veteranit të rrethit bën pranimin e kërkesës dhe të dokumentit vërtetues me të cilin kërkohet njohja e statusit të veteranit të luftës ANÇL dhe i jep mendimin e tij për to komisionit qendror.

IA- KËRKUESI DHE PRANIMI I DOKUMENTEVE

1-Kërkuesi i statusit të veteranit është personi që kërkon t'i njihet statusi, ose familjari i

veteranit të vdekur. Në vend të kërkuesit që është gjallë, në pamundësi shëndetësore mund të paraqitet një familjar i autorizuar i tij.

2- Pranimi i kërkesës dhe i dokumentave bëhet nga anëtari (antarët) e Komisionit që janë në pritje në ditët e caktuara në selinë e komisionit të rrethit ose nga Sekretaria e Degës së Mobilizimit Ushtarak. Personi që dorëzon kërkesën dhe dokumentet, i lëshohet një vërtetim në të cilin shkruhet data e dorëzimit, sasia e dokumenteve dhe numri i protokollit në regjistrin e Komisionit të rrethit.

3- Personi që paraqet kërkesën plotëson dhe firmos formularin përkatës me të dhëna për adresën e tij, dhe inventarin e dokumenteve që paraqet kur këto nuk i ka kërkesa e tij me shkrim. Formulari firmoset edhe nga anëtari i Komisionit, specialisti i tij ose sekretaria e Degës së Mobilizimit Ushtarak që bën pranimin fillestar të kërkesës dhe dokumenteve.

4- Bashkë me kërkesën dhe dokumentin vërtetues, personi paraqet çertifikatën e gjendjes civile dhe atë të gjendjes familjare, kur kërkuesi i statusit ka vdekur ose ka qënë kryefamiljar i bazës së Luftës ANÇL.

5- Kërkuesi i statusit të veteranit të Luftës ANÇL i paraqet kërkesën dhe dokumentin në rrethin ku banon, ku ka regjistrin e gjendjes civile.

6- Dokumentet vërtetuese për Statusin e Veteranit që paraqiten duhet të plotësojnë kushtet teknike si vijon :

- Të jenë të vulosura qartë me vulën e Institucionit që i ka lëshuar.
- Të jenë të firmosura nga titullari përkatës ose personi i autorizuar prej tij.
- Kur paraqiten dëshmi personale, firma e deklaruesit të jetë e vërtetuar nga noteri.
- Dokumenti të ketë shënuar qartë numrin e protokollit të institucionit që e ka lëshuar dhe datën e lëshimit të tij.
- Dokumenti të mos ketë korigjime.
- Emri, Atësia dhe Mbiemri i personit në dokumentin vërtetues të përputhet saktësisht, gërmë për gërmë me identitetin e kërkuesit sipas çertifikatës së gjendjes civile.

Kur dokumenti nuk plotëson kërkesat teknike të mësipërme, mangësitë i bëhen të njohura kërkuesit dhe i rekomandohet që t'i plotësojë ato.

7- Anëtarë të Komisionit të Statusit të Veteranit të rrethit dëgjojnë vërejtjet dhe ankesat e kërkuesve, u japin përgjigje dhe i raportojnë komisionit për t'u dhënë zgjidhje. Pritja bëhet me një libër të veçantë, të regjistruar në sekretarinë e Degës së Mobilizimit Ushtarak.

8- Kërkesat dhe dokumentat e dërguara në Departamentin e Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës në vitin 1996 e në vazhdim i dërgohen Degës së Mobilizimit Ushtarak të rrethit përkatës e cila i vë në dispozicion të Komisionit të Statusit të Veteranit, i cili, kur është e nevojshme njofton personat përkatës të paraqiten  që të plotësuar kërkesat që shtrohen në këtë udhëzim.

9- Kërkesat dhe dokumentet për Statusin e Veteranit të Luftës ANÇL pranohen deri me 30 shtator të vitit 2000. Mbyllja e afatit të pranimit bëhet me datë 1 tetor të vitit 2000 me një proçesverbal të posaçëm në të cilin shënohet numri i kërkesave të pranuara. Proçesverbali firmoset nga gjithë antarët e komisionit të rrethit dhe hartohet në dy kopje. Njëra dërgohet në Departamentitn e Veteranëve të Luftës në Ministrinë e Mbrojtjes dhe tjetra dorëzohet ne sekretarinë e Degës së Mobilizimit Ushtarak të rrethit.

- Komisioni i rrethit nëse nuk ka përfunduar vazhdon punën për shqyrtimin e kërkesave edhe pas datës 30 shator të vitit 2000 sipas grafikut të dërguar nga Departamenti i Veteranëve të Luftës.

10- Anëtarët e Komisionit të Statusit të Veteranit të rrethit konfirmojnë dokumentet e lëshuara nga institucioni të cilin përfaqësojnë.

Komisioni, kur është e nevojshme bën verifikime dhe kërkon informacion për çdo dokument që shqyrton.

## IB-SHQYRTIMI I KËRKESAVE NË KOMISIONIN E RRETHIT

11- Mbledhja e Komisionit të Statusit të Veteranit të rrethit zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve bashkë me kryetarin e tij.

12- Në mbledhjen e Komisionit mbahet proçesverbal dhe firmoset vendimi, një kopje e të cilit protokollohet dhe arkivohet në Sekretarinë e Degës së Mobilizimit Ushtarak të rrethit.

13- Komisioni i Statusit të Veteranit të rrethit merr në shqyrtim kërkesat dhe dokumentat e

paraqitura sipas kohës kur ata kanë bërë kërkesë. Si rregull në një mbledhje shqyrton një për një nga 50 deri në 100 kërkesa. Në rastin kur kërkuesi nuk ka plotësuar si duhet dokumentet, kjo shënohet në protokoll dhe i kthehet përgjigje në të cilën i kërkohet të plotësojë mangësitë teknike sa më parë të jetë e mundur, gjithnjë brenda datës 30 Shtator të vitit 2000. Një kopje e përgjigjes mbetet në dosje.

14- Dosjet e plotësuara në rregull diskutohen në mbledhjen e Komisionit i cili shënon në vendimin e vet mendimin e tij me shumicën e votave të antarëve të Komisionit që kanë marrë pjesë në atë mbledhje.

Për kërkesat që vendos të dërgojë lart, Komisioni i rrethit shënon numrin e dosjes dhe harton listën e tyre.

15- Vendimi i Komisionit të rrethit që përmban mendimin e tij firmoset nga kryetari i tij dhe nga anëtarët që marrin pjesë në atë mbledhje. Firma e Kryetarit të Komisionit shoqërohet me vulën e Degës së Mobilizimit Ushtarak.

16- Dosjet me kërkesat e shqyrtuara nga Komisioni i rrethit nisen brenda muajit në Departamentin e Veteranëve të Ministrisë së Mbrojtjes.

## II. DEPARTAMENTI I VETERANËVE DHE INVALIDËVE TË LUFTËS, SI ORGAN QË ORGANIZON E DREJTON PUNËN PËR STATUSIN E VETERANIT KA PËR DETYRË:

1- I paraqet Drejtorisë së Plan-Financës kërkesat për shpenzimet financiare-administrative të Komisioneve të rretheve dhe të Komisionit Qendror të Statusit të Veteranit të Luftës ANÇL.

2- Harton e paraqet për miratim projekt-urdhërin për organikën e përkohëshme të Stafit teknik të Komisionit Qendror e të grupeve të studimit dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Personel-Arsimimit zgjedh e propozon specialistët e punonjësit.

3- Mban lidhje e korrespondencë me Komisionet e rretheve.

4- Organizon punën për kualifikimin e Komisioneve të Statusit të Veteranit të rretheve, nëpërmjet seminareve, ekipeve të ndihmës e të asistencës teknike .

5- Administron dokumentacionin e paraqitur nga Komisionet e rretheve.

6- Organizon studimin e kërkesave dhe dokumenteve për Statusin e Veteranit dhe paraqet në Komisionin Qendror listat përkatëse me mendimin e Komisionit të rrethit dhe propozimin e tij.

7- Krijon kushte pune për veprimtarinë e Komisionit Qendror të Statusit të Veteranit.

## III. KOMISIONI QENDROR I STATUSIT TË VETERANIT TË LUFTËS ANÇL SHQYRTON DHE VENDOS PËR NJOHJEN OSE JO TË STATUSIT TË VETERANIT TË LUFTËS.

### IIIA- SHQYRTIMI I DOKUMENTEVE

1- Mblidhet jo më pak se 2 herë në muaj me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së antarëve të tij dhe vendos me shumicë absolute të pjesëmarrësve. Si rregull në një mbledhje shqyrtohen 100 deri në 300 dosje. Për raste të veçanta vendos vetë Komisoni Qendror.

2- Në mbledhjen e tij mbahet proçesverbal në të cilin shënohen emrat e pjesëmarrësve, rendi i ditës, dhe rezultatet e votimit për rastet që shqyrtohen.

3- Komisioni Qendror firmos vendimin e tij të mbledhjes i cili protokollohet e arkivohet në Sekretarinë e Ministrisë së Mbrojtjes. Mbi bazën e tij plotësohet vendimi individual për çdo dosje listat e shpërblimit dhe listat e rivlerësimit, të cilat dërgohen në Institutin e Sigurimeve Shoqërore jo më vonë se 15 ditë nga mbledhja e Komisionit. Listat firmosen nga Kryetari i Komisionit Qendror. Në mungesë të tij e me porosi firmosen nga Nënkryetari, (Drejtori i Departamentit të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës).

### III B- NJOFTIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTEVE

4- Njoftimi i Komisionit Qendror me shkrim për vendimin përkatës i niset Veteranit ose kërkuesit të Statusit jo më vonë se 15 ditë nga Mbledhja e Komisionit Qendror.

5- Librezat e Veteranit dhe Dëshmitë (për veteranët e vdekur) plotësohen nga stafi teknik i Komisionit Qendror, vulosen edhe me vulën e thatë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe nisen në Degën e

Mobilizimit Ushtarak jo më vonë se 20 ditë nga mbledhja e Komisionit Qendror.

6- Libreza dhe dëshmia e veteranit i dorëzohen veteranit ose pjestarit të familjes të autorizuar që paraqesin letër njoftimin personal ose autorizimin përkatës. Dega e Mobilizimit Ushtarak bën njoftimin e personit ose të familjes dhe mban evidencë të rregullt për datën e dorëzimit duke depozituar në çdo rast emrin dhe firmën e personit që e ka marrë

7- Stafi teknik i Komisionit Qendror dhe grupi i studimit i specialistëve drejtohen nga Departamenti i Veteranëve të Luftës (Drejtori e Zëvendësdrejtori).

III C- NË RASTET E ANKIMIT NË GJYKATË

8- Komisioni Qendror në rastet kur vendimet e tij bëhen objekt gjykimi cakton përfaqësuesin e tij për mbrojtjen e vendimeve të tij në gjykatë, i cili është jurist, ose një specialist i Departamentit të Veteranëve ose kur shihet e nevojshme një antar i Komisionit Qendror.

9- Si rregull Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit njihet me vendimin e gjykatës për çdo rast dhe diskuton e vendos ta pranojë apo apelojë atë. Rastet që nuk presin për shqyrtim në Mbledhjen e Komisionit Qendror shqyrtohen nga një grup i antarëve të tij i cili mban qëndrim dhe raporton më pas në mbledhjen e Komisionit Qendror.

IV. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës ANÇL, Departamenti i Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës, Drejtoria e Organizimit Ushtarak, Drejtoria e Plan-Financës, Komisionet e Statusit të Veteranit dhe Degët e Mobilizimit Ushtarak në rrethe.

V. TË FUNDIT

Udhëzimi i Ministrit të Mbrojtjes Nr.335, datë 23.06.1995, "Për zbatimin e Ligjit Nr.7874, datë 17.11.1994, "Për Statusin e Veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.190, datë 03.05.1995, shfuqizohet.

VI. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MBROJTJES
**Luan Hajdaraga**

**KËRKESË**

KËRKUES: Valbona Balliu, e bija e Lutfiut dhe e Bukuries e datëlindjes 23.05.1968, lindur dhe banuese në Gramsh, me arsim të mesëm, e martuar me dy fëmijë.

OBJEKTI: Kërkohet shpallja si të zhdukur që nga viti 1995 të bashkëshortit tim Tahir Qemal Balliu.

BAZA LIGJORE: Neni 15 e vijues i K, civil dhe nenit 375 të K. Pr. Civile.

PËRPARA

GJYKATËS SË RRETHIT

GRAMSH

Zoti Kryetar !

Unë kërkuesja Valbona Lutfi Balliu, jam martuar me Tahir Qemal Balliu me 5 Nëntor 1989. Gjatë jetës sonë bashkëshortore kemi kaluar mirë pa asnjë problem. Kemi lindur dy fëmijë, Silvin të datëlindjes 19.07.1990 dhe Lindion të datëlindjes 1993.

Për arsye ekonomike bashkëshorti im Tahir Qemal Balliu është larguar më 13.01.1995.

Që nga dita e largimit dhe deri më sot nuk kam marrë asnjë informacion për vendndodhjen e tij, dhe nëse është apo s'është gjallë.

Kam bërë të gjitha përpjekjet duke pyetur me gjithçka ka qenë e mundur për të marrë ndonjë informacion, por deri tani nuk kam marrë asgjë.

Në vështrim të nenit 15 të K. Civil të Republikës së Shqipërisë personi që mungon nga vendbanimi i tij dhe për të cilin nuk ka lajme për vendndodhjen e tij me gjithë interesimet e bëra në organet shtetëtore të vendit tonë dhe jashtë shtetit në Greqi, nuk kemi marrë asnjë lajm se ku ndodhet dhe nëse është gjallë ose jo, si dhe meqenëse ka afro pesë vjet nga koha e largimit, kërkoj shpalljen e tij si të zhdukur nga viti 1995.

Për këtë, kërkoj, nga ana e gjykatës që të pranohet kërkesa me qëllim që të vazhdojë procedura e mëtejshme sipas ligjit.

KËRKUESJA
**Valbona Balliu**

Doli nga shtypi më 17.3.2000

| Tirazhi: 4000 copë | Formati: 60x88/8 |
| --- | --- |

Shtypshkronja ALBDESIGN sh.p.k.
Tiranë, 2000

Çmimi: 150 lekë